



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPSTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e IV-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
15 prill 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloi në ora 14:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Agron Përçuku, Shkëlzen Xhaferi dhe Enis Maxhuni), si dhe nga sekretaria e kuvendit BASTRI Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapë dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu theksoi se kanë ardhur edhe këto pika shpesh për t'u futur në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit janar – mars 2021 për të hyrat dhe shpenzimet;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave së mbeturinave për familjet me asistencë sociale në Komunën e Vushtrrisë;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për përkrahje financiare të personave të prekur nga pandemia Covid 19;
- Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:***

### R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 mars 2021;
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar – mars 2021;
3. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;
4. Shqyrtimi i peticionit të parashtruar nga Fitim Pllana;
5. Shqyrtimi i Raportit janar – mars 2021 për të hyrat dhe shpenzimet;

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave së mbeturinave për familjet me asistencë sociale në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për përkrahje financiare të personave të prekur nga pandemia Covid 19;
9. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri;
10. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 mars 2021.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 11 mars 2021.***

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar – mars 2021.

**Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë për Inspektime** – tha se e pashë që ka ardhë e skanuar si gjysmake kjo informatë. Me siguri i është ngatërruar sekretarisë së kuvendit, sepse ne të kompletuar e kemi dorëzuar.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së** – theksoi se do ta shikojmë bashkë me sekretarinë se ku është problemi dhe se për kuvend do ta dërgojmë të kompletuar.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.***

3. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore.

**Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë për Inspektime** – prezantoi në pika të shkurtra informatën. Ai theksoi se për shkak të pandemisë, ndoshta aktiviteti ka qenë pak më i mangët, edhe pse ne vazhdimisht kemi bërë kontrolle. Por, për shkak se në disa raste edhe nuk kanë punuar bizneset dhe se ankesat e qytetarët kanë qenë më të vogla.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.***

4. Shqyrtimi i petitionit të parashtruar nga Fitim Pllana.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se si KPF mund ta diskutojmë dhe ta procedojmë në kuvend këtë petition, por e kemi parë në rrjete sociale se atij i është premtuar se do t'ia japin në shfrytëzim. Ai i ka filluar punimet, e pastaj ja kanë ndërprerë punimet. Prandaj, kam parë vullnet tek të gjithë për t'i ndihmuar Fitimit, por ta gjejmë formën se si t'i ndihmojmë.

**Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë për Inspektime** – edhe pse nuk është në domenin e drejtorisë sime, por ndoshta Fitimi së pari është dashur të udhëzohet që të kërkoj pronën në shfrytëzim, sepse prona që ka filluar punimet nuk është pronë e tij private, por pronë publike.

Mua inspektorët më kanë njoftuar se ja kanë ndërprerë punimet, sepse nuk posedon dokumentacion.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – theksoi se çështja e Fitimit tashmë është bërë e njohur për komunën dhe qytetarët, por edhe për blerësit. Ajo tha se të gjithë qytetarët nuk i dinë procedurat. Ajo çka kemi parë në rrjete sociale, premtimi i është dhënë nga kryetari i komunës gjatë fushatës dhe sa kam informacione, ai i ka zhvilluar procedurat, ka bërë kërkesë në disa drejtori. E përkrahu këtë peticion që të shkojë në kuvend që të diskutohet dhe të merret një vendim në pajtim me ligjin.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – e kemi biseduar në të kaluarën që ta krijojmë si praktikë që të shtjerrët si mjet që drejtorja të ndihmojë në këso raste. Kjo nuk do të thotë që ne jemi kundër, por qëllimi është që ta gjejmë formën që t'i ndihmojmë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – e mbështes edhe unë këtë peticion, vetëm të gjendet forma se si t'i ndihmojmë. Sa i përket peticionit, duhet që të figurojë emri, mbiemri, numri personal dhe nënshkrimi. Ndoshta këtë nuk e ka parë kryetari i komunës, sepse është i prirur që të konstatojë se a është fals apo jo. Tek ky peticion po e shoh këtë mangësi që mungon numri personal.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ta sjell një rekomandim për gjetjen e një zgjidhjeje dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim*

5. Shqyrtimi i Raportit janar – mars 2021 për të hyrat dhe shpenzimet.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** –tha se ndoshta është mirë të ceket në këtë vendim burimi i të hyrave se nga cilat kategori krijohen këto shpenzime.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksave së mbeturinave për familjet me asistencë sociale në Komunën e Vushtrrisë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për përkrahje financiare të personave të prekur nga pandemia Covid 19.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se ky propozim ka ardhë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale pa asnjë arsytim. Ne vitin e kaluar e kemi marrë një vendim dhe jemi pajtuar të gjithë. Nuk është punuar kurrë lidhur me zbatimin e këtij vendimi. Një takim e kemi mbajtur në komision, ku unë kam dhënë dorëheqje, sepse komuna po kërkon nga komisioni që ta përgatis në tërësi dokumentacionin dhe t'i marr të gjitha përgjegjësitë. Si Lëvizje për Bashkim ne nuk e përkrahim këtë propozim – vendim.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – ajo kërkoi që të fillojnë menjëherë procedurat që qytetarët t'i marrin mjetet financiare, dhe të fillojë zbatimin e vendimit të kuvendit të cilin e kemi marrë dhe se edhe mjetet financiare janë ndarë. Edhe unë personalisht, por edhe si PDK jemi kundër këtij vendimi që të shkoj në kuvend.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – kërkoi sqarime nga komisioni se pse nuk po implementohet vendimi i vitit të kaluar. Ku janë problemet? Sa është implikimi buxhetor i vendimit të mëhershëm dhe sa do të jetë i këtij propozim vendimi? Sa është numri i të infektuarve për vitin 2020 dhe për tremujorin e parë të vitit 2021? Ai propozoi që shuma të jetë 100 euro, pasi që shuma prej 50 euro është e vogël përkundër shpenzimeve të tyre.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se vendimin e vitit të kaluar e kemi shqyrtuar në mbledhjen e bordit dhe kemi ardhur në përfundim që është vështirë i zbatueshëm, pasi që komisioni e ka të vështirë ta verifikoj burimin e të hyrave financiare. Sa i përket propozimit që shuma e kompensimit të jetë 100 euro, a tha se nuk kemi mjete financiare. Gërguri deklaroi se përafërsisht janë rreth 2000 të infektuar në komunën tonë.

**Gresa Muli, anëtare e KPF-së** – ajo tha se me vendimin e kuvendit që është marrë në dhjetor 2020 është paraparë që t'iu jepen 150 euro për familjet që kanë të ardhura financiare më pak se 350 euro dhe që të zbatohet në mënyrë retroaktive nga janari 2021. Ajo tha se asnjë procedurë nuk është filluar që të krijohet një platformë për aplikim. Muli deklaroi se asnjë komision nuk e ka për obligim që të krijojë forma të aplikacionit dhe t'i kryej krejt procedurat, sepse ato i takojnë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Ajo tha se ka qenë e vështirë të vërtetohet se sa kanë të ardhura familjet, sepse as ATK-ja e as Qendra për Punë Sociale nuk na kanë ofruar ndihmë. Në komision iu kamë thanë që duhet ta gjej një zgjidhje drejtoria. Unë po flas për veti se ma mirë është që të gjithëve t'iu jepet një shumë financiare se kjo forma aktuale pasi që duhet të maltretohen shumë qytetarët me dokumentacione.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se propozimi aktual që na ka ardhur është hajgare, por nuk është në rregull të rritet edhe më tutje shuma financiare. Qeveria e Kosovës është ajo që duhet të përkujdeset për krejt qytetarët e Republikës së Kosovës. Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale (QPS) e kanë numrin e qytetarëve që marrin asistencë sociale.

Ai tha se kam dhënë dorëheqje nga komisioni, sepse Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në mungesë të drejtorit nuk e ka ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim. Pas disa muajve neve na thirrën si komision dhe na thanë që ju duhet me përgatit platformën e aplikacionin. Ne nuk jemi të specializuar për me përgatit platforma. Prandaj, për këtë arsye kam dhënë dorëheqje

për neglizhencën e drejtorisë dhe QPS-së. Ka qenë një kohë që IKSHP nuk ka bërë testime dhe qytetarëve iu kanë dhënë që të vetizolohen për 14 ditë. Prandaj, ka qytetarë që e kanë kaluar Covidin pas pasur mundësi me u testu dhe se kjo iu bëhet e padrejtë atyre. Prandaj, unë do ta përkrahu një vendim që iu ndihmohet familjeve në nevojë.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – theksoi se ka raste që kur janë bërë testime për Covid është testuar një anëtar i familjes. Unë personalisht jam testuar dhe jam dal me Covid, kurse as fëmijët e as vjehrrin nuk e kanë testuar. Kur e kemi bërë testin serologjik, rezultatet kanë dalur që e kanë kryer edhe anëtarët tjerë të familjes. E mora shembull familjen time dhe se shumica e familjeve kështu ku janë testuar një apo dy anëtarë, kurse anëtarët tjerë nuk janë testuar. Lidhur me vendimin që e kemi marrë në dhjetor, ajo tha se kemi diskutuar gjerë e gjatë dhe në fund jemi dakorduar dhe e kemi marrë një vendim bashkërisht. Prandaj, ka mundësi të gjendet rruga për zbatimin e tij.

**Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së** – kur e kemi votuar vendimin në dhjetor kemi menduar se po bëjmë një gjë të mirë. Por, po shihet se s'po gjen zbatim, prandaj duhet që ta përkrahim këtë propozim vendim të ri.

**Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – tha se cilido vendim që zbatohet ndoshta nuk është mënyra më e mirë dhe më e drejtë për qytetarët. Ai tha se të gjithë qytetarët nuk kanë shpenzuar njëjtë për t'u shëruar nga Covid-i. Sepse, ata që kanë qenë të hospitalizuar kanë shpenzuar më shumë se të tjerët.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së** –deklaroi që t'i bëhet një arsyetim për kuvend këtëj propozimi dhe të ceket që do të zbatohet edhe retroaktiv dhe të ceket se çfarë implikimesh buxhetore do të ketë.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me 5 vota “për” dhe 3 “kundër” rekomandoi që t'i bëhet një arsyetim dhe të bëhen disa plotësime dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

9. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se draft-statuti është i hartuar nga niveli qendror dhe është bërë unik për të gjitha komunat. Por, vetëm te emërtimi të vendoset emri i Dr. Safet Idrizit ashtu siç kam propozuar.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

10. Të ndryshme.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – duke pasur parasysh që është përfolur shumë vendimi që është marrë në kuvend lidhur me rimëkëmbjen ekonomike ku janë ndarë 140 mijë euro, si anëtar i kuvendit dëshiroj ta di se deri ku ka arritur ky proces, a është bërë ndonjë projekt. Ai kërkoi nga qeveria komunale që ta sjell në kuvend një raport apo informatë lidhur me këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën **15:05**.

**Bujar Klinaku**

*Bujar Klinaku*  
Procesmbajtës



**Nasuf Aliu**  
Kryesues i KK-së dhe i KPF- së